

Sinjalizime

Ekskluzive | Bastisje për armë në Gjilan, Policia gjen pushkë gjuetie dhe municion në shtëpinë e 33-vjeçarit



Sinjali.com

13 Korrik 2026 08:43



Një aksion i Policisë së Kosovës, i realizuar në bazë të urdhrit të Gjykatës Themelore në Gjilan, ka përfunduar me sekuestrimin e një arme zjarri dhe municionit në një shtëpi në fshatin Uglar, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se më 12 korrik, hetuesit e Njesisë për Hetimin e Krimeve në Gjilan kanë ekzekutuar një urdhër kontrolli në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të Jeton Rexhepit rreth 33 vjeç, i dyshuar për armëmbajtje pa leje.

Gjatë bastisjes, Policia ka gjetur dhe sekuestruar një pushkë gjuetie, si dhe gjashtë fishekë të kalibrit 12 GA, të cilat janë marrë si prova materiale.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se 33-vjeçari është shoqëruar në ambientet e Policisë, ku është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës.

Pas përfundimit të procedurave dhe në konsultim me Prokurorin e Shtetit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa ndaj tij do të procedohet kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Gjilan për veprën penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë

bastisje

Gjilan

Policia

Të tjera:



Policia e Vlorës: 65 të arrestuar dhe mbi 700 doza drogë të sekuestruara gjatë...

Shqipëri



Rezikuan pushuesit pranë bregut me mjete lundruese, Policia gjobiti me mbi 10 mijë euro dy...

Shqipëri



Ekskluzive | Sherr në kompaninë “ILKO” në Vushtrri, vëllai ther me thikë vëllanë – babai...

Ekskluzive




Ekskluzive | Arsenal armësh e qindra fishekë zbulohen në një shtëpi të braktisur në veri –...

Ekskluzive



Zhduket 32-vjeçari nga Prishtina, familja alarmon Policinë – vuan edhe nga probleme...

Sinjalizime



Vrasja e 40-vjeçarit me katër mbiemra në Laç, policia deklaratë zyrtare: Humbi jetën në spital,...

Shqipëri



Begaj kalon transit në Kosovë, Policia njofton për kufizime në trafik

Siguri



Kontrolli policor në Gazivodë i zbulon marihuanë në çantën e shoferit, 30-vjeçari në...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera